



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORATI

Nr. 1808/1 Prot.

Vlorë, më, 18.11.2020

**VENDIM**

**Nr.25 datë 18. 11. 2020**

**PËR**

**“MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DREJTORES SË KOMUNIKIMIT DHE TË BURIMEVE NJERËZORE, PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARISË NDIHMËSAKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE INSTITUCIONALE NË DISTANCË”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, referuar situatës së krijuar dhe në zbatim të protokolleve shëndetësore anti Covid-19, përmes votimit elektronik të zhvilluar online në datën 18.11.2020, Rektorati

**VENDOSI**

1. Veprimtaria ndihmësakademiike me karakter mësimor/administrative dhe ajo administrative institucionale do të realizohet në distancë(online).
- Gjatë kësaj periudhe do të kryen të gjitha detyrat funksionale të titullarit të institucionit për pjesën akademike dhe ai për pjesën administrative financiare.
2. Duke respektuar protokollat shëndetësor, me urdhër/njoftim të Rektorit/Administratorit apo të eprorit të drejtpërdrejtë, çdo punonjës është i detyruar të paraqitet në punë(zyrë), për të përmbushur detyrat që do të vlerësohen nga eprorët se nuk mund të realizohen në distancë.
3. Orari i punës për personelin e UV-së, në ambjentet e institucionit, do të jetë 08.00-13.00.Pjesa tjetër e orarit zyrtar të punës do të realizohet online.
4. Drejtoritë/Sektorët të cilat ofrojnë shërbime do të kombiinojnë punën në mjediset e institucionit me atë online, duke proceduar përmes grafikut të hartuar nga Drejtori/Përgjegjësi dhe të miratuar nga Rektori/Administratori, në zbatim të varësisë funksionale.Zyrat e studentit, të cilat kryejnë arkëtime ( pagesa e tarifës së studimit apo dhe të tjera shërbime), do të vijojnë të punojnë në institucion sipas orarit 08:00-14:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORATI

5. Sekretaritë mësimore do të vijojnë punën në institucion sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe drejtuesi i njësisë kryesore. Orari i punës do të jetë 08:00-14:00.
6. Në njësitë kryesore ku zhvillohen laboratore, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor, do të vazhdojë punën sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe drejtuesi i njësisë kryesore.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Vendimi do të zbatohet deri në një vendim të dytë të Rektoratit, në varësi të situatës Covid-19.**

REKTORI

  
Prof. Dr. Roland ZISI

